



Data: 21.09.2015

Për: “Shqiponja M” sh.p.k, Lagje Drita, Burrel

Procedura e prokurimit: **Tender i hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitim dhe sistemim i sheshit në qendër të fshatit Asim Zeneli, Qendër e Komunës Antigone”.**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike, 06.07.2015**

Njoftojmë se kanë qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit me vlera përkatëse të ofruara:

<b>Nr</b>	<b>Operatori Ekonomik</b>	<b>Oferta (pa TVSH)</b>
1.	Eral Construction Company	15,392,520
2.	Shqiponja M	15,465,357
3.	Elkri	18,100,380
4.	Derveni 1	18,281,200

5.	Bahas	18,285,940
6.	BO Arti & Iliria D	18,580,880
7.	Mane/S	18,888,888
8.	BE – IS	20,025,641
9..	Bean	20,133,988
10.	BO Feba & Ed Konstruksion	20,551,850
11.	Al Asfalt	20,850,220
12.	Sireta 2F	22,222,222
13.	Xhast	22,995,000

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**Shoqëria “Eral Construction Company” sh.p.k. për arsye se:**

Nuk ka paraqitur dokumentacion për inxhinierin gjeodet. Ka paraqitur dokumentacion për një inxhinier gjeolog, i cili nuk mund të kryejë detyrat e gjeodetit.

**Shoqëria “Elkri” sh.p.k. për arsye se:**

Nuk plotëson kërkesën për realizimin e punëve të ngjashme, pasi mungon marrëveshja e bashkëpunimit për kontratën e ngjashme që ka deklaruar. Kjo kërkesë është përcaktuar qartë në kërkesat për kualifikim.

Nuk plotëson kërkesën për stafin drejtues pasi mungon diploma e ing mekanik Aristidh Braçka.

Nuk plotëson kërkesën për disponimin e mjeteve, pasi ka paraqitur dokumentacion vetëm për dy kamione nga katër të kërkuar në kërkesat për kualifikim.

Nuk plotëson kërkesën për deklarimin e stafit drejtues, pasi nuk ka paraqitur deklaratën për inxhinieret.

**Shoqëria “Derveni 1” sh.p.k. për arsye se:**

Nuk plotëson kërkesën për realizimin e punëve të ngjashme, pasi mungon marrëveshja e bashkëpunimit për kontratën e ngjashme që ka deklaruar. Kjo kërkesë është përcaktuar qartë në kërkesat për kualifikim.

Nuk plotëson kërkesën për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit, pasi mungon vërtetimi për xhiron, i kërkuar në kërkesat për kualifikim.

**Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Arti” sh.p.k. (70%) dhe “Iliria D” sh.p.k. (30%) për arsye se:**

Shoqëria “Arti” sh.p.k, e cila ka marrë përsipër punime në shtresat rrugore, nuk plotëson kërkesën për disponimin e stafit të nevojshëm pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për një inxhinier ndertimi.

Shoqëria “Iliria D” sh.p.k, e cila ka marrë përsipër punimet e gërmimit, nuk plotëson kërkesën për disponimin e mjeteve të nevojshme, pasi nuk disponon ekskavatorët e kërkuar.

Shoqëria “Iliria D” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën për disponimin e stafit, pasi nuk ka paraqitur diplomën e inxhinierit gjeodet.

**Shoqëria “Mane/S” sh.p.k, për arsye se:**

Nuk plotëson kërkesën për disponimin e stafit, pasi nuk ka paraqitur diplomën e inxhinierit të ndërtimit Bledar Mane, ing. elektrik Gjergji Klimi dhe ing. hidroteknik Mihal Çavo.

Nuk plotëson kërkesën për disponimin e mjeteve të nevojshme, pasi ka vetëm 1 kamion mbi 10 ton nga dy të kërkuar në kërkesat për kualifikim.

**Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Feba” sh.p.k. (60%) dhe “ED Konstruksion” sh.p.k. (40%) për arsye se:**

Në marrëveshjen e bashkëpunimit nuk janë ndarë punët që ka marrë përsipër të kryejë secila kompani, dhe në këtë mënyrë komisioni e ka të pamundur të gjykojë për plotësimin e kërkesave teknike për kualifikim.

Shoqëria “Feba” sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratën për gjendjen gjyqësore.

Shoqëria “Feba” sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimet vendore në Gjirokastrë, vend ku ushtron aktivitet referuar ekstraktit të QKR.

Shoqëria “Feba” sh.p.k. nuk ka paraqitur formularin e vlerësimit për punën e ngjashme.

Shoqëria “Feba” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion për ing mekanik, elektrik dhe gjeodet ndërkohë që në marrëveshje nuk janë ndarë punët dhe ajo mund të kryejë punime në këto specialitete.

Shoqëria “Feba” sh.p.k. nuk ka paraqitur çertifikatën ISO 14001 - 2004.

**Të skualifikojë shoqërinë “Xhast” sh.p.k. për arsye se:**

Shoqëria “Xhast” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion për shlyerjen e taksave vendore në Golaj – Kukës, vënd ku kjo shoqëri ushtron aktivitet, referuar ekstraktit të QKR.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“Shqiponja M” sh.p.k, Lagje Drita, Burrel, se me ofertën e paraqitur në shumën 15,465,237 Lekë (pa TVSH), është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë: Në datë 27.08.2015

Ankesa:

1. Ankesë nga ana e operatorit ekonomik “Mane/S” sh.p.k, me datë 07.09.2015 dhe ka marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktor me datë 10.09.2015.

